

 REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI I SHKËRIMIT: DATE OF REPORTING: 17.08.2020			Nr. i Fjalëve: No. of Pages:
Media Orig. / Orig. Jedin. / Org. Unit:	Subjekt / Klasif. Kod / Class. Code:	Nr. Prot. / Or. Prot. / Prot. No.:	Nr. i Fjalëve: No. Pages:
04	47	1456	15

Zyra e Kryetarit K.K NOVOBËRDË | 2020



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës



Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KRYETARIT

DATË/A:	06.08.2020
PËR/ZA/TO:	Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)
Cc/Cc:	
NGA/OD/FROM:	z.Svetislav Ivanovic- Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Plani i Veprimit i Menaxhmentit

Për zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim
 Nr. i dokumentit : 04/17/1070/2, të datës 15.07.2020

Nr.	Kompetencat e Auditimit (të gjetura)	Klasifikimi i Gjeturave e rendësisë së: lart / mesme / e ult	Rekomandimet	Veprimet e Menaxhmentit	Data e planifikuar e adresimit të rekomandimit nga menaxhmenti	Drejtoriu /sektori ku është dhënë Rekomandimi nga ZKA
1	Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores		Kryetari duhet të sigurojë që janë	Ne pas pranimit të raportit filan nga ZKA-ja bashkarisht i gjith	31.12.2020	Drejtoria e Financave

<p>01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.</p> <p>Në tri raste pagesat ishin ekzekutuar nga thesari në kategori të gabuar në vlerë 4,413€.</p> <p>Pagesa në vlerë 1,500€ është bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për subvencionimin e OJQ-ve;</p> <p>Pagesa në vlerë 2,383€ është bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për paga jubilarë dhe të pensionimit; dhe</p> <p>1 Si dhe një pagesë prej 530€ është ekzekutuar prej thesarit për mbylljen e kredit kartelës së kryetarit nga kategoria e subvencioneve e që do të duhej të paguhej nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte planifikuar mjete të mjaftueshme në këto kategori.</p>		<p>ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.</p>	<p>stafi i Drejtorisë së Financave kemi shiqur të gjeturat ku do të zbatojm rekomandimet e dhëna nga ZKA-ja ashtu siq e përcakton Rregullorja nr.01/2013 të MF</p>		
---	--	--	--	--	--

2	<p>Çështja A1 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave</p> <p>Sipas nenin 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.</p> <p>Komuna në vitin 2019, prej 3184 prona të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 397 apo 12.5% të pronave të paluajtshme. Kjo ka ndodhë për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale dhe dobësi në organizim të veprimeve për inspektim të objekteve.</p>	I lart	<p>Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që bëhet verifikimi i pronave sipas kërkesës ligjore, në mënyrë që shënimet rreth latimit në pronë janë të plota dhe të sakta.</p>	<p>Ne gjatë periudhës së vitit 2020, zyrtarët anketues I kemi angazhura më tepër për realizimin e planit të punës së tyre, pasi që po kemi veshtërsi me autonjetelet zyrtare po shpresojm që këtë vitë do të realizohet I tër plani ashtu siq edhe e përcakton Ligji 06/L-005</p>	31.12.2020	Drejtoria e Financave
3	<p>Çështja C1 - Mangësi tek kontratat për shërbime të veçanta</p> <p>Sipas neni 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.</p> <p>Komuna kishte angazhuar dy persona me kontrata për punë dhe detyra specifike, ku punonin për periudhën kohore më të gjatë se katër (4) muaj brenda një viti. Sipas komunës kjo kishte ndodhur për funksionalizimin e</p>		<p>Kryetari duhet të sigurojë se angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se katër muaj.</p>	<p>Gjatë vitit 2019 komuna është detyruar të punësoj dy zyrtar me kontrat për shërbime të veçanta për arsye të hapjes së Qendres për regjistrimin e Autonjeteve në bazë të memorandumit të nënshkruar nga Kryetari I Komunës dhe Sekretari përmament I Ministris së Punve të Brendshme.</p> <p>Në muajin shkurt të vitit 2020 është shpallur konkurs për rekurrim dhe tani këto pozita që</p>	E zbatuar	Administrata Komunale

	qendrës së regjistrimit të automjeteve.			kan qenë me kontrat për shërbime të veqanta nuk janë duke punuar më kështu që në vitin 2020 deri më tani nuk kemi raste të tilla që punojnë me shërbime të veqanta.		
4	<p>Çështja C2 - Mangësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit në shërbimin publik</p> <p>Sipas nenit 95 të UA (MPMS) 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe nenit 32 të Rregullores nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, të gjithë aplikuesit që plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit ftohen për t'u nënshtruar testimit.</p> <p>Me rastin e punësimit të një arsimtarit për matematikë dhe fizikë, të një Asistenti Administrativ dhe të një Zyrtari për Arsim, komuna nuk ka zbatuar testimin me shkrim për përzgjedhje të kandidatëve, mirëpo ka kaluar direkt në intervistim të kandidatëve. Në nuk kemi marr sqarimet e nevojshme nga komuna për shkakun e përsëritjes së rekomandimit nga</p>	I lart	Kryetari duhet të sigurojë se rekrutimet të behen përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore, duke aplikuar testimin me shkrim për kandidatët potencial.	Kjo e gjetur në vitin 2020 nuk do të përsëritet dhe se gjat procedurave të rekrutimit do të respektojmë këtë të gjetur dhe se në të ardhmen do të pregadisim edhe teste me shkrim për kandidatët që do të konkurrojnë .	31.12.2020	Drejtoria e Arsimit

	viti i kaluar, edhe pse është zotuar me plan veprimi që kjo e gjetur nuk do të përsëritet.					
5	<p>Çështja A2 - Zhvillimi i procedurave të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak të AQP-së</p> <p>Sipas nenit 9.6 të LPP nëse aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. Komuna kishte zhvilluar dy procedurastë prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe nuk e kishte bërë njoftimin e AQP-së duke ja dërguar Deklaratën e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para iniciimit e aktivitetit përkatës të prokurimit. Kjo ka ndodhur për shkak funksionimi jo efektiv i kontrolleve zyrtarit përgjegjës të prokurimit për ta njoftuar</p>		Kryetari duhet të sigurojë se atëherë kur paraqiten nevoja për blerje jashtë planit duhet të vendosen mekanizma për njoftim paraprak të organeve relevante sipas kërkesave ligjore.	Zyra e prokurimit për të gjitha aktivitetet e prokurimit që nuk janë në prokurim derdon në AQP të gjitha deklaratat e nevojave por ë rastin konkret kan qen gabime teknike të cilat do të mundohemi apo do te jemi me te kujdesëshëm që këto gabime teknike most ë na paraqiten në të ardhmen	E Zbatuar	Zyra e Prokurimit

6	<p>AQP-në</p> <p>Çështja B2 - Mosrespektim i procedurave në ndarje të subvencioneve</p> <p>Sipas nenit 2.1 të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve përcakton që Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje.</p> <p>Komuna kishte lidhur marrëveshje të mirëkuptimit me OJQ "CPT" për realizimin e projektit për "Ndihma për të diplomuarit nga komuniteti pakicë për t'u kyçur në administratën publike në nivel qendror dhe lokal". Mirëpo marrëveshja e mirëkuptimit ishte bërë duke anashkaluar procedurat e përcaktuara me Rregulloren për financim publik të OJQ-ve, ku kërkohet konkurrueshmëri, transparencë, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim. Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka përfillur procedurat e parapara</p>	I lart	Kryetari të sigurohet se marrëveshjet duhet të nënshkruhen vetëm atëherë ku paraprakisht janë zbatuar të gjitha procedurat e përcaktuara ligjore, me qëllim që paratë publike të kontrollohen dhe financimi i OJQ të jetë në përputhje me rregullat.	Ne pas pranimit të vërejtjeve apo të gjeturave ku është specifikuar kjo e gjetur në vitin 2020 nuk do ta përsërisim një gabim të till.	31.12.2020	Menaxhmenti i lart dhe drejtoria e Financave
---	---	--------	--	--	------------	--

	Rregulloren për financimit publik të OJQ-ve.					
7	<p>Çështja B3- Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit</p> <p>Sipas nenit 28.10 të LPP, Autoriteti Kontraktues (AK) është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë AK nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Komuna filluar procedurat e prokurimit për Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe ka lidhur kontratë në vlerë 60,000€ pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njësive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimi efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.</p>		Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve pa projekte ekzekutuese	Ne pas pranimit të raportit final këtë vit kemi filluar që asnjë projekt mos të iniciohet pa projekt detal.	E zbatuar	Njësiti kërkuese & Zyra e Kryetarit
8	Çështja A3- Specifikimi teknik i tenderit jo i qartë	I lart	Kryetari të	Pas pranimit të raportit është	E zbatuar	Njësiti kërkuese

<p>Sipas nenit 28.4 të LPP, AK do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian, (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim gjithashtu neni 28.8 "Kërkesat ekzekutive dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj AK që të shpërblejnë kontratën"</p> <p>Në dy projekte me rastin e formulimit të specifikave teknike nuk ishte bërë sipas kërkesave ligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Për asfllimin e rrugëve në fshatrat e Novobërdës në vlerë 159,305€, nuk është përcaktuar standardi i cilësisë apo peshës mbajtëse të gypave të betonit dhe nuk është përcaktuar se a kërkohet gypi të jetë i armuar apo jo; dhe ▪ Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në komunën e Novobërdës 2019-2020 kontratë 	<p>sigurohet që njësitë bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit dhe zyra e prokurimit të forcoj kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione të jo të qarta.</p>	<p>kërkuar nga njësit kërkuese që gjatë hartimit të specifikimi teknik të jen të kujdesëshëm dhe sa me të qarta specifikimet teknike</p>	
---	---	--	--

<p>kornizë në vlerë 60,000€, komuna nuk kishte përcaktuar standardin për shtylla e drurit për të cilat kërkohet vetëm gjatësi por jo edhe trashësia/diametri e tij apo edhe shtazhionimi i tij në bitum për të rezistuar lagështisë.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak se njësia kërkuese nuk ka pasur plan ekzekutiv të ndërtimit i hartuar në mënyrë profesionale dhe paramasa është hartuar nga stafi komunal që nuk kompetencën e nevojshme.</p>					
<p>9. Çështja A4 - Parregullsi në procesin e prokurimit</p> <p>Sipas nenit 56.15 të rregullës për udhëzuesin operativ të prokurimit, kurdo që AK nuk e din sasinë indikativë, kontratat me çmime për njësi AK duhet të përcaktojnë peshën në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose secilit artikull në mënyrë AK të përcaktojnë se cila është oferta më e lirë. Për kontratën ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Novobërdës 2019-2020 komuna kishte lidhur kontratë me çmim për njësi dhe me vlerë të parashikuar 60,000€. Edhe pse komuna kishte një vendim nga kuvendi komunal se në cilat rrugë do të instalohet ndriçimi publik si dhe ka</p>	I lart	<p>Kryetari, të sigurohet se njësitë kërkuese bëjnë analizë të drejtë të nevojave, duke u bazuar në kërkesat/ nevojat reale të komunës duke përfshirë edhe analizimin e kontratave paraprake që do t'u mundësonte kursim të buxhetit.</p>	<p>Pas pranimit të raportit është kërkuar nga njësitë kërkuese që gjatë hartimit të specifikimit teknik të jenë të kujdesëshëm dhe sa më të qarta specifikimet teknike</p>	E zbatuar	Njësitë kërkuese

	<p>pasur kontrata paraprake të ngjashme, e ka vazhduar procedurën për kontratë me çmim për njësi. Gjatë realizimit ka rezultuar që OE fitues të dalë për 16,959€ më i shtrenjtë se OE i tretë i përgjegjshëm, dhe e tërë kjo do të mund të parandalehej sikur komuna të bënte vlerësim më të mirë të nevojave dhe të lidhte kontratë publike kornizë.</p> <p>Zhvillimi i procedurës me kontratë me çmim për njësi ka bërë që komuna mos t'i peshoj drejtë zërat përbërës të çmimit me nevojat reale e rrjedhimisht gjatë zbatimit të kontratës të paguaj më shumë.</p>					
10	<p>Çështja A5 - Ndarje jo e duhur e detyrave</p> <p>Sipas nenit 62.3.7 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik, një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit.</p> <p>Në tri aktivite të prokurimit, Kryetari i Komisionit të vlerësimit të ofertave ishte caktuar edhe menaxher i kontratës. Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve përkatës në caktimin anëtarëve të komisionit dhe menaxherit të projektit.</p>		<p>Kryetari duhet të sigurohet që të shmangen konfliktet e interesit, duke caktuar zyrtar të ndryshëm në vlerësim të ofertave dhe menaxhim të kontratave.</p>	<p>Mungesa e stafit jo adekuat për ta bërë në situatë të tilla por që të ardhmen do të jemi më të kujdesshëm gjat ndarjes së detyrave.</p>	U zbatuar	Zyra e Prokurimit & Zyra e Kryetarit
11	<p>Çështja B4 - Regjistri jo i plotë pasurive</p> <p>Neni 6, pika 3 i rregullores MF - nr.</p>		<p>Kryetari duhet të</p>	<p>Komuna për vitin 2019 ka arritur të regjistroj të gjithë pasuritë</p>	31.12.2020	Zyra e Kryetarit & Drejtoria e Financave

	<p>02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se të gjitha Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.</p> <p>Komuna edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka arrit të vlerësoj regjistroj automjetet, tokat dhe ndërtesat që janë në pronësi të komunës.</p> <p>Në tri raste pagesat në vlerë 4,819C për blerje të pasurisë jo kapitale gjatë vitit 2019 nuk ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë. Gjithashtu, komuna nuk e aplikoi sistemin e-pasuria për regjistrim e pasurisë, duke bërë që pasuria jo kapitale dhe stoqe të mos jen të shpalosur në PFV.</p>		<p>sigurojë se të gjitha blerjet dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen saktë në regjistrin e pasurive nga zyrtari i pasurive në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive.</p>	<p>komunale ndërsa për vitin 2020 në baz të planifikimeve do të bëhet edhe vlersimi i pasurive të regjistruara</p>		
12	<p>Çështja A6 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë</p> <p>Sipas neni 4.1 të rregullores MF- nr. 02/ 2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën.</p> <p>Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedurave të brendshme për</p>		<p>Kryetari të sigurohet se janë hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Gjithashtu të</p>	<p>Drejtoria e Financave do të inicioj rregulla të brendshme lidhur me inventarizimin e pasurisë komunale në baz të rregullores së MF-nr.02/2013</p>	31.12.2020	<p>Drejtoria e Financave & Zyrtari Kryesor Administrative.</p>

	<p>evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë të komunës.</p> <p>Sipas neni 19.4.3 të rregullores MF - nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare, përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjësi për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe Identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur.</p> <p>Komuna ka realizuar inventarizimin e pasurisë për vitin 2019, megjithatë raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë dhe me regjistrin nga e-pasuria. Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.</p>		<p>sigurohet se bëhen krahasimet e raporteve të inventarizimit me regjistrat pasurisë dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.</p>			
13	<p>Çështja B5 - Sfidat në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme</p> <p>Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e</p>	<p>Drejtoria e Financave pas konsultimeve me ekipin e auditimit kur kanë qene në vizit tek ne, ku kemi ndërmarr hapat për borgjlinjë të mëdhenjë që tju dërgojm vërejtjet për kryerjen e obligimeve që kanë ndaj komunës në të kundërtën nëse nuk ju përgjigjen vërejtjeve do të kalojnë përmes procedurave përmbarimore.</p>	30.10.2020	Drejtoria e Financave	

	<p>apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjohën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendrike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Edhe për vitin 2019, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.</p>		<p>brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.</p>			
14	<p>Çështja B6 - Vonesa në arkëtimin e qirasë</p> <p>Sipas nenit 5 të kontratave 02-725 dhe 09-221 për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, qiraja vjetore paguhet deri më 1 prill të çdo viti për vitin paraprak. Në dy raste të audituara qiraja vjetore prej 5.315€ për shfrytëzim të pronës së paluajtshme nuk ishte paguar që nga viti 2016 dhe vlera e obligimeve që këta dy shfrytëzues i</p>		<p>Kryetari duhet të sigurohet sa janë marr masat e ligjore për arkëtimin e qirasë për shfrytëzimin e pronës publike si vërejtje dhe procedimin mbledhje të detyrueshme</p>	<p>Menaxhmenti pas pranimit të raportit final ka thirrur në takim komisionin i cili është i përbër nga 5 antar dhe ka kërkuar nga ky komision që ti kontaktoj qiramarrësit për ti kryer obligimet e tyre që kanë ndaj komunës, ne tani për tani na u janë përgjigjur shumica prej tyre dhe po presim që gjatë këtij viti ti përmbysin të gjith obligimet që kanë ndaj komunës.</p>	31.12.2020	<p>Komisioni për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim</p>

	kishin komunës ishte 21,260€. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte ndërmarr veprime të mjaftueshme për arkëtimin e këtyre të hyrave.		përmes përmbartimit.			
15	<p>Çështja C3- Vonesa në pagimin e faturave</p> <p>Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për LMFP që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.</p> <p>Thesari ka ekzekutuar pagesën në vlerë prej 3,344€ sipas vendimit gjyqësor për obligimet e papaguara për më shumë se 5 muaj vonesë ndaj ofruesit të shërbimit nga të cilat 2,831€ për obligimet dhe 513€ për shpenzimet e përmbartimit.</p> <p>Ekzekutimi i kësaj pagese ka ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e komunës për pagesën në kohë të faturave për shpenzime komunale.</p>		Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Cjatiç periudhës së vitit vijues të ta zbatojm këtë rekomandim ashtu siq e parasheh edhe Ligji nr.03/L-048	31.12.2020	Drejtoria e Financave & Zyra e Kryetarit
16	Çështja B7 - Mos raportim i rregullt i obligimeve të papaguara		Kryetari, duhet të	Ne për vitin 2020 do ta zbatojmë	31.12.2020	Drejtoria e Financave

<p>Sipas nenit 5.2 të Rregullës financiare 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të Organizatave Buxhetore, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara, përmes raporteve mujore duke përfshirë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.</p> <p>Komuna gjatë vitit 2019, asnjëherë nuk e kishte bërë raportimin e rregullt mujor të obligimeve, kërkesë e Rregullës Financiare 02/2013 të M.F-së. Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionit të kontrolleve në Zyrën e Financave.</p>	<p>forcoj kontrollet lëdhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara, të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF në përputhje me kërkesat ligjor.</p>	<p>rekomandimin e e dhënë nga ZKA-ja</p>		
---	--	--	--	--

Me respekt;

